



Nr. REF-H/R: 10/2021

Data: 07/04/2021

Për: **z. Albin Kurti**, Kryeministër i Republikës së Kosovës
C.C: **z. Liburn Aliu**, Ministër i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës,
C.C: **znj. Albulena Haxhiu**, Ministre e Ministrisë së Drejtësisë
C.C: **z. Jetish Maloku**, Kryesues i Këshillit Prokurorial të Kosovës,
C.C: **z. Blerim Isufaj**, Kryeprokuror i Prokurorisë Speciale të Kosovës,
C.C: **z. Skender Cocaj**, Kryesues i Këshilli Gjyqësor të Kosovës,
Nga: **z. Kenan Gashi**, Drejtor Ekzekutiv i Rrjetit të OJQ-ve AVONET,
Lënda: Kërkesë për inicim të hetimeve
Raporti i monitorimit të rastit të Nexhat Krasniqit

Rrjeti i OJQ-ve AVONET duke monitoruar dhe hulumtuar rastet për **Keqpërdorim të Pozitës apo Autoritetit Zyrtar si në nivelin lokal dhe atë qendror gjen shkelje të rënda në rastin e të dënuarit z. Nexhat Krasniqi** i cili për një periudhë të gjatë ka qenë i punësuar si Drejtor i Prokurimit në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë, më pas, me 01.02.2008, ka kaluar në pozitën e Drejtorit të Prokurimit në Ministrinë e Transportit dhe Postë Telekomunikacionit (tani Ministria e Infrastrukturës dhe Transportit).

AVONET gjen se i njëjti, përderisa ka qenë i punësuar si Drejtor i Prokurimit në MTI është larguar nga puna, bazuar në Aktgjykimin të Gjykatës Themelore të Prishtinës PKR 144 i datës 21 shtator 2015, me të cilin është dënuar me dy (vjet) e dy (2) muaj

burgim, gjegjësisht 26 (muaj) për veprën penale **“keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar”**, Aktgjykim të cilin Gjykata e Apelit e ka vërtetuar me Aktgjykimin PAKR nr.603/2015, datë 20 maj 2016, ku të njejtit i është shqiptuar dënimi me burgim një (1) vit gjashtë (6) muaj, gjegjësisht 18 (tetëmbdhjet muaj), për veprën penale **“keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar”**, ky aktgjykim është i plotëfuqishëm.

Për rastin në fjalë edhe Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës kishte nxjerrë Aktgjykimin PML. nr..329/2016 datë 2 mars 2017 me të cilin është vërtetuar Aktgjykimi PAKR nr.603/2015 datë 20 maj 2016 të Gjykatës së Apelit në Prishtinë, me të cilin është dënuar me burgim 1 (një) vit e 6 (gjashtë) muaj për veprën penale **“keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar”**, ky aktgjykim është i formës së prerë.

Duke kontestuar drejtësinë, z. Krasniqi ka parashtruar edhe një kërkesë në Gjykatën Kushtetuese të Kosovës për vlerësimin e kushtetutshërisë së Aktgjykimit PML nr. 329/2016 datë 2 mars 2017 të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, e cila kërkesë me anë të Aktvendimit (si Aktvendim përfundimtar) për PAPRANUESHMËRI nr.ref: PK 1191/18, datë 5 shkurt 2018 është refuzuar si e papranueshme.

Duke u bazuar në Aktgjykimin e Gjykatës Themelore të Prishtinës PKR 144 i datës 21 shtator 2015, Aktgjykimin PAKR nr.603/2015, datë 20 maj 2016, të Gjykatës së Apelit në Prishtinë, Aktgjykimin PML. nr..329/2016 datë 2 mars 2017 i Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, Aktvendimin për PAPRANUESHMËRI nr.ref: PK 1191/18 datë 5 Shkurt 2018 të Gjykatës Kushtetuese, është vërtetuar se z. Nexhat Krasniqi ka kryer veprën veprën penale të **“keqpërdorimit të pozitës apo autoritetit zyrtar”**, dhe për këtë është shpallur fajtor dhe është dënuar me burgim një (vjet) e gjashtë (6) muaj.

Mbi bazën e këtij aktgjykimi Sekretari i Përgjithshëm u.d i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Transportit me vendimin nr.01.10641 datë 12.11.2018 Udhëheqësit të Divizionit të Prokurimit z.Nexhat Krasniqi i është shqiptuar masa disiplinore **“Ndërprerje e Mardhënies së Punës në Shërbimin Civil”**, për shkak të kryerjes së vepres penale **“keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar”**. duke u mbështetur në nenin 63, par. 4 të Ligjit nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, në

Rr.”Ramadan Rexhepi”ish objekti i QAP, 70 000 Ferizaj, Kosovë

e-mail: avonet.rks@gmail.com

Cel: +383 44 800 114 & +383 44 800 343

të cilin thuhet se: *“Nëse nëpunësi civil shpallet fajtor dhe dënohet për kryerje të veprës penale, autoritetet kompetente administrative detyrohen që nga ato elemente të vendimit të gjykatës kompetente, që përbëjnë shkelje të parimeve dhe të rregullave administrative, duhet të urdhërojnë shkarkimin e nëpunësit civil”*. Ndaj këtij vendimi, ai ka parashtruar ankesën A.Nr.745/2018 të datës 16.11.2018 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës(KPMSHCK), të cilën me vendimin nr.7520/2018 datë 10.12.2018 e ka hudhur poshtë si të palejuar.

Nexhat Krasniqi në cilësinë e propozuesit ka parashtruar propozim me datë 22.11.2018 për përmbarrim në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm-Divizoioni Civil, në bazë të këtij propozimi Gjykata ka nxjerrë Aktvendimin Cp.nr. 2257/18 me të cilin ka detyruar Ministrinë e Infrastrukturës dhe Transportit që të lejoj Nexhat Krasniqin të ushtroi detyrën e Udhëheqësit të Divizionit të Prokurimit dhe të mosë marrë asnjë veprim tjetër administrativ për këtë procedurë deri në marrjen e vendimit përfundimtarë nga ana e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (KPMSHCK), lidhur me ankesën e ankuesit, duke mos e prezentuar vendimin e KPMSHC për hudhje poshtë të ankesës. Nga shkresa shihet se vendimi nuk kishte baze për ekzekutim dhe ligjerisht nuk duhej ti nenshtrohej përmbarrimit nga ana e gjyqtarit.

Kundër Aktvendimit Cp.nr. 2257/2018 MIT përmes Avokaturësh Shtetërore ka paraqitur Prapësim AVSH nr.10 datë 30.04.2019 në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm i së cilës ka refuzuar prapësimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës-Ministria e Infrastrukturës i parashtruar kundër aktvendimit për caktim të përmbarrimit të lëshuar nga Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, Cp.nr.2257/18, i nxjerrë me datë 22.05.2019.

Ministria e Drejtësisë-Avokatura Shtetërore në cilësinë e përfaqësuesit të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Transportit kishte parashtruar ankesën AVSH nr.10 datë 31.05.2019 kundër vendimit Cp.nr.2257/18 datë 22.05.2019 të Gjykatës Themelore në Prishtinë- Departamenti i Përgjithshëm.

Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm me rastin e **vërtetimit të plotëfuqishmërisë të aktvendimit Cp.nr.2257/18 me datë 25.07.2019** nga gjykatësi Arton Fazliu, ka bërë shkelje absolute të nenit 207 paragrafi 1, të Ligjit nr.03/L-006 për Procedurën Kontestimore me të cilin është përcaktuar si në vijim: citat:” ankesa e paraqitur brenda afatit ligjor e pengon përmbarimin e aktvendimit, në qoftë se me këtë Ligj nuk është parashikuar ndryshe”, dhe shkelje absolute të nenit 268 paragrafi 4, të Ligjit nr.04./L-149 për Procedurën Përmbarimore me të cilin është përcaktuar si në vijim: citat ”përmbarimi i aktvendimit ose i urdhrit për realizimin e kredive bëhet pasi të skadoi afati për paraqitjen e ankesës nga personat të cilëve u takon e drejta e ankimit kundër tij”.

Pas këtyre veprimeve të keqpërdorimit zyrtar AVONET ka reaguar me deklaratë për media me datë 09 gusht 2019 kundër veprimeve të gjyqtarit z. Arton Fazliu për keqpërdorim të pozitës apo autoritetit zyrtar dhe i gjithë ky reagim ka rezultuar me aktvendime me të cilat është vërtetuar se z. Nexhat Krasniqi ka kryer veprër penale.

Gjykata Supreme e Kosovës me Aktvendimin CML.nr.12/2019 ka Aprovuar si të bazuar Kërkesën Për Mbrojtjen të Ligjshmërisë të Prokurorit të Shtetit të Republikës së Kosovës KMLC.nr.138/2019 datë 22.08.2019 dhe është ndryshuar Aktvendimit i Gjykatës Themelore në Prishtinë Cp.nr.2257/2018 datë 22.05.2019 dhe Aktvendimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.3056/2019 datë 25.07.2019 ashtu që Aprovohet Si i Bazuar Prapësimi i Debitorit të Përmbarimit Qeveria e Kosovës-Ministria e Infrastrukturës me seli në Prishtinë i paraqitur kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë datë 15.04.2019 me të cilin është caktuar përmbarimi i vendimit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nr.6897 datë 16.11.2018, lihet jashtë fuqie ky aktvendim për caktim përmbarimi dhe refuzohet si i pabazuar propozimi i kreditorit për lejimin e përmbarimit të këtij vendimi.

Gjykata Themelore në Prishtinë më datë 20.12.2019 ka bërë Tërheqjen e Urdhërit për Përmbarim Cp.nr.2257/18 bazuar në Aktvendimin CML.nr.12/2019 të Gjykatës Supreme të Kosovës.

Përkundër të gjitha fakteve dhe trajtimit të kësaj lënde edhe nga Gjykata Supreme e Kosovës, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ka nxjerr Vendimin KPSHCK- 2959/2020 datë 04.12.2020 ku ka aprovuar si të bazuar Ankesën A.nr.77/2019 datë 07.02.2019 e parashtruar nga ankuesi Nexhat Krasniqi, i cili është në kundërshtim me vendimin nr.7520/2018 datë 10.12.2018 me të cilin KPMSHC e ka hudhur poshtë si të palejuar ankesën A.Nr.745/2018 të datës 16.11.2018 të ankuesit Nexhat Krasniqi.

Andaj, për të njejtin rast kemi dy vendime të KPMSHC e të cilat janë në kundërshtim me njëri- tjetri, e kjo përbën shkelje të rëndë të ligjit sepse për të njejtin rast janë nxjerr dy vendime në kundërshtim njëri me tjetrin.

Nga kjo del se KPMSHC ka bërë trajtimin e ankesës së Nexhat Krasniqit dhe atë pas çdo afati të mundshëm ligjor, ku këtë e ka konstatuar edhe vet KPMSHC që ankesa është trajtur jashtë çdo afati pasi që nuk ka pasur përbërjen e duhur, por askund në asnjë bazë ligjore nuk i jepet një mundësi e tillë që të bëhet trajtimi apo shqyrtimi i ankesave pas afateve madje kjo paraqet shkelje absolute.

Meqenëse për këtë ka nxjerr Aktvendim edhe Gjykata Supreme e Kosovës kjo lëndë paraqet çështje të gjykuar dhe veprimi nga ana e KPMSHC konsiderohet vepër penale bazuar në nenin 394 "Mosekzekutimi i vendimeve gjyqësore" ku përcaktohet, citoj: *"1. Personi zyrtar apo personi përgjegjës, i cili refuzon të ekzekutoj urdhrin, vendimin apo aktgjykimin e plotfuqishëm të ndonjë gjykate të Republikës së Kosovës apo i cili nuk e ekzekuton vendimin brenda afatit ligjor apo afatit të caktuar me vendim, dënohet me gjobë ose me burgim deri në dy (2) vjet"*. dhe nenit 414, i cili përcakton, citoj: *"1. Personi zyrtar, i cili duke shfrytëzuar detyrën apo autoritetin zyrtar i tejkalon kompetencat e tij ose nuk i përmbush detyrat zyrtare të tij me qëllim që të përfitoj çfarëdo dobie për vete ose për personin tjetër apo që t'i shkaktojë dëm personit tjetër ose që t'i shkel të drejtat e personit tjetër, dënohet me burgim prej një (1) deri në tetë (8) vjet"* të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

KPMSHC i është referuar nenit 6 paragrafit 1 nënparagrafit 1.1 të Ligjit për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës e që ky ligj, ky nen nuk ka

Rr."Ramadan Rexhepi"ish objekti i QAP, 70 000 Ferizaj, Kosovë

e-mail: avonet.rks@gmail.com

Cel: +383 44 800 114 & +383 44 800 343

dispozita të tilla pasi që ka vec nen, paragraf dhe nënparagraf dhe nuk ka pikë sic i janë referuar. Poashtu, i është referuar nenit 16 duke mos precizuar asnjë paragraf dhe si i tillë nuk mund të dihet cili paragraf është aplikuar, e me të vetmin qëllim duke qenë se ky nen përcakton afatin për parashtrimine ankesës e që vendimi është marr jashtë cdo afati ligjor.

Gjithashtu, Ligji për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbyesit Civil në nenin 16 dhe 17 përcakton afatin e vendosjes nga ana e KPMSHC që përcaton afatin 45 ditë ndërsa tani kemi vendimin e KPMSHC datë 04.12.2020 që ka aprovuar ankesën e datës 07.02.2020.

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Infrastrukturës ka nxjerr Vendimin nr.01-10242 datë 22.12.2020 me të cilin zbatohet vendimin A.nr.77/2019 i KPMSHC dhe ka kthyer në vendin e punës Nexhat Krasniqin si Udhëheqës i Divizionit të Prokurimit në Miniistrinë e Infrastrukturës me të gjitha të drejtat dhe detyrimet nga marrëdhënia e punës duke i kompensuar pagat nga dita e ndërprerjes së marrëdhënies së punës. I njëjti duke qenë në dijeni për Aktvendimin e Gjykatës Supreme të Kosovës ka kthyer në punë z. Nexhat Krasniqi kështu duke treguar papergjegjësi dhe shkelje të Ligjit sepse Aktvendimet e formës së prerë janë të zbatueshme dhe mos zbatimi i tyre sjell përgjegjësi penale.

AVONET konsideron se një veprim i tillë i z.Bytyqi përbën shkelje të Ligjit dhe i njëjti duhet të shkoj në përgjegjësi për shkak të veprimeve të tij.

Po ashtu, edhe nga ana e ish-ministrit të MI z.Arban Abrashi ishte një hezitim për mostrajtimin e kësaj lënde duke pasur në dispozicion të gjithë materialin dhe të gjitha aktvendimet e të gjitha niveleve të gjykatave.

AVONET shprehet i shqetësuar për këtë neglizhencë nga ana e ish ministrit z.Abrashi sepse kemi të bëjmë me shkelje absolute të ligjit dhe kjo çështje është dasht që të trajtohet nga të gjithë mekanizmat brenda MI.

Ministria e Infrastrukturës ka paraqitur padi për anulimin e Vendimit A.nr.77/2019 datë 04.12.2019 në Gjykatën Themelore në Prishtinë së bashku me

propozimin për shtyerjen e ekzekutimit të vendimit A.nr.77/2020 datë 04.12.2020 bazuar në të dhënat që i cekem më lartë.

Përkundër, Aktvendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës dhe se kjo paraqet çështje të gjykuar -res judicata Gjykata Themelore në Prishtinë ka marr Aktvendimin A.nr.17/2021 datë 11.01.2021 me të cilin ka refuzuar kërkesën e paditëses-propozueses për shtyerjen e ekzekutimit të vendimit të lartëcekur me arsyetimin se nuk ka të bashkagjitur ndonjë fakt të bazuar në ndonjë provë që kishte mundur të bënte të besueshme pretendimet e saj si dhe vendimi i goditur me padi do t'i sillte dëm, se dëmi vështirë do të riparohej dhe se shtyerja nuk është në kundërshtim me interesin publik.

Bazuar në të gjitha këto të cekurat në Aktvendimin A.nr.17/2021 datë 11.01.2021 AVONET konsideron se gjyqtarja ka shkelur ligjin sepse kjo lëndë është çështje e gjykuar dhe moszbatimi i vendimeve gjyqësore paraqet vepër penale dhe cenon interesin publik dhe drejtësinë në përgjithësi.

Po ashtu, AVONET ngreh shqetësimin edhe për mos përfaqësimin e duhur nga Avokatura Shtetërore të kësaj lënde meqenëse të njëjtin nuk kanë siguruar prova të mjaftueshme sa i përket propozimit për shtyerjen e vendimit A.nr.17/2021.

AVONET ju rikujton AVSH se ata janë të autorizuar që të përfaqësojnë ministrinë në procedura gjyqësore dhe janë të obliguar që këtë përfaqësim ta bëjnë në mënyrë profesionale dhe mbrojtjes sa më të mirë të institucionit. Në këtë rast AVSH ka dështuar që të përfaqësoj profesionalisht këtë lëndë dhe ka rrezikuar interesin publik, përkundër që kanë qenë të informuar dhe kanë përfaqësuar këtë çështje që nga fillimi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës i ka shërbyer më së keqi drejtësisë, duke vepruar në kundërshtim me rendin juridik dhe parimin e sigurisë publike.

Kërkojmë nga Prokuroria Speciale që të filloj hetimin ndaj z.Eshref Sabani-Kryetar i Kolegjit në kuadër të KPMSHCK për shkeljet që ka bërë me nxjerren e vendimit jashtë çdo afati të paraparë ligjor dhe në kundërshtim me Aktvendimin CML.nr.12/2019 e

Rr."Ramadan Rexhepi"ish objekti i QAP, 70 000 Ferizaj, Kosovë

e-mail: avonet.rks@gmail.com

Cel: +383 44 800 114 & +383 44 800 343

Gjykatës Supreme të Kosovës me të cilin kjo çështje konsiderohet si çështje e gjykuar-res judicata.

Po ashtu, kërkojmë që hetimi të filloj edhe ndaj sekretarit të Ministisë së Infrastrukturës z. Izedin Bytyqi për nxjerrjen e vendimit për kthimin në punë të zyrtarit, i cili ka qenë i dënuar për vepër penale të cilën e ka vërtetuar edhe Gjykata Supreme e Kosovës me Aktvendimin CML.nr.12/2019 datë 18.11.2019, njëherit i njëjti ka qenë në dijeni për këtë Aktvendim dhe mozbatimi i vendimeve gjyqësore përbën vepër penale në bazë të Kodit Penal të Kosovës dhe z.Byqyqi duhet të jap përgjegjësi për këto veprime.

AVONET gjithashtu kërkon që pjesë e hetimit të jetë edhe gjyqtarja e Gjykatës Themelore të Prishtinës znj. Luljeta Maxhuni, e cila ka nxjerr Aktvendimin A.nr.17/2021 datë 11.01.2021 duke refuzuar propozimin për shtyerje të ekzekutimit të vendimit të KPSHCK-së A.nr.77/2019 i datës 04.12.2020 dhe ka rrezikuar rendin dhe sigurinë publike, duke mos trajtuar në mënyrë profesionale shkresat e lëndës dhe duke mos marr parasysh Aktvendimin e Gjykatës Supreme të Kosovës.

AVONET vlerëson se kjo lëndë nuk është përfaqësuar në mënyrë profesionale nga Avokatura Shtetërore, meqenëse në Aktvendimin A.nr.17/2021 datë 11.01.2021 të Gjykatës Themelore të Prishtinës thuhet se nuk janë sjell prova të mjaftueshme që të aprovohet ky propozim.

Kërkojmë nga Kryeministri i Republikës së Kosovës z. Albin Kurti dhe Ministri i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, Liburn Aliu që sa më parë të reflektoj dhe ta zbatoj Aktvendimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, me të cilin është Aprovuar Kërkesa Për Mbrojtjen e Ligjshmërisë të Prokurorit të Shtetit të Republikës së Kosovës.

Rastin i Nexhat Krasniqi, ka qenë target edhe nga zyret ndërkombëtare dhe kjo ishte edhe temë e trajtimeve dhe luftimin e korrupsionit edhe nga përfaqësuesit ndërkombëtar.

Me respekt,

Rr."Ramadan Rexhepi"ish objekti i QAP, 70 000 Ferizaj, Kosovë

e-mail: avonet.rks@gmail.com

Cel: +383 44 800 114 & +383 44 800 343
